

**PARASHQEVIA OF FATOS KONGOLI, THE VOICE OF
REFERENCES IN ALBANIAN LETTERS (ON THE NOVE “BOLERO
IN THE OLD MAN’S COTTAGE”)**

**PARASHQEVIA E FATOS KONGOLIT, ZË RRËFYES NË LETRAT
SHQIPE (MBI ROMANIN “BOLERO NË VILËN E PLEQVE”)**

Adelina XHAFERI¹

¹*Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

**Corresponding author e-mail: adelina.xhaferi@unite.edu.mk*

Përmbledhje

Me anë të këtij vështrimi të shkurtër letrar mbi personazhin e Parashqevisë mëtohet të tregohet se si ky personazh, i veçantë jo vetëm për nga karakterizimi, por edhe për nga vetë funksionimi dhe raporti me personazhet tjerë, bëhet një zë rrëfyes për fatin e vajzave shqiptare të viteve ‘97. E dhënë përballë një gjenerate të vjetër (dy pleqve të vilës dykatëshe) që ekziston me bindje shumë më ndryshe nga bindjet që ka vetë kjo protagoniste (brezi i një “gjenerate të dalë jete”), romani e ballafaqon edhe lexuesin me një kohë që nuk e ka brenda vetes vetëm të mirën, të drejtën dhe atë që mbrohet, por edhe vetë të keqen pavarësisht zgjatjes së saj në hapësirat e (para)caktuara për veprim të (pa)zakonshëm.

Andaj, duke e njohur vetë natyrën e kësaj protagonisteje, kësaj dëshmie të gjallë mbi përjetimet e hidhura të ‘97-ës dhe nevojën që përjetimi i saj të ngërthehet në vetë rrjedhën e asaj që quhet letërsi bashkëkohore shqipe, edhe ky punim mëton që figurën e tillë ta (për)afrojë te koha jonë gjithnjë në krahasim të brendshëm të vetes. Kjo kumtesë gjithashtu, duke u mbështetur në vetë romanin në fjalë, do të ndihmojë edhe në njohjen e asaj se sa ne e bëjmë të drejtën, të nevojshmen apo të detyrueshmen në një rreth që nuk na vlerëson për atë që jemi, e shumë më shumë se kaq as nuk e ndihmon një njohje jashtë nevojave fizike dhe erotike.

Fjalët kyçe: Parashqevia, letërsia, rrëfimi, hapësira shqiptare, personazhet.

Janë të shumtë shkrimtarët të cilët i përkasin periudhës bashkëkohore të letërsisë shqipe e që krijimtarinë e tyre letrare e kanë vendosur brenda hapësirave të zakonshme shqiptare (dhe jo vetëm), duke ndihmuar në këtë mënyrë jo vetëm identifikimin e një trualli që ndër shekuj nxjerr krijues të arrirë, por që në të njëjtën kohë ta dëshmojnë edhe lidhjen që njeriu shqiptar kishte me artin e letërsisë. Letërsia duke qenë se ka aftësinë që një përjetim njeriu (a populli) ta paraqesë te bota e lexuesve nëpërmjet një figuracioni të arrirë në mënyrë që ta bëjë vetëdijesimin ose njohjen e tij mbi atë përjetim, atëherë po atë gjë e realizon edhe për një personazh të vetëm.

<https://doi.org/10.62792/ut.filologjia.v12.i22-23.p2494>

Ky i fundit me tërë natyrën dhe karakterizimin e tij të veçantë mund të jetë në rrjedha të vazhdueshme të vetë kohës që përfshihet në vepër e që ndihmon në paraqitjen sa më të plotë të vetë asaj vepre, ose në raste të tjera në të njëjtën kohë mund të jetë edhe larg saj. Në rastin kur në të gjitha këto çaste rrjedhëse romanesh dallohen personazhe që harrojnë ta vlerësojnë vetveten edhe përkundër asaj që ua jep rrethana e që detyrohen ta trashëgojnë; që harrojnë të dashurojnë pa shenja të njëpasnjëshme djallëzie dhe egoizmi në një marrëdhënie që i njeh pa maska e rrugës ua vesh të tillat; që harrojnë të jetojnë lirshëm dhe pa nevojë rrëfimi te dikush që mëton të dijë gjithçka mbi ta dhe jetën e tyre në hapësira të ngushta shqiptare (dhe jo vetëm); ose të përkushtohen rrënjësisht mbi një çështje të caktuar jete pavarësisht rrethanave dhe nevojave të një sistemi kohor, nuk mund të mbetet anash dhe pa u përmendur as edhe personazhi rrëfimtar me emrin **Parashqevi**.

Kjo protagoniste femër në romanin e Kongolit “*Bolero në vilën e pleqve*” në të njëjtën kohë e në të njëjtin vend e jep ballafaqimin, mospërputhjen dhe ndeshjen ndërmjet dy gjeneratave të ndryshme (gjeneratës së të rinjve dhe asaj të të moshuarve). “*Kam lindur në një qytet bregdetar*”.¹ Kështu e paraqet rrëfimin mbi veten, vendin dhe jetën e saj kjo protagoniste me rol të rrallë e të veçantë në historinë e letrave shqipe, nga e cila jo gjithçka pritet të dalë siç bëjnë rëndom personazhet tjerë, lufta e vazhdueshme e të cilëve është mbrojtja e gjërave personale dhe jo ashtu siç vazhdon më tej rrëfimi i Parashqevisë: “*Atdheu ynë i bekuar ka disa qytete-porte, të vegjël e të mëdhenj. Duke dashur të ruaj një të fshehtë, vendin e lindjes sime, nuk po ia përmend emrin. Nuk po përcaktoj as përmasat e tij, futet në portet e mëdhenj apo të vegjël. As pozicionet gjeografike, në jug, në mes apo në veri. Po them se ishte dhe është një qytet-port ku unë s’kam shkelur prej shumë vitesh, qysh se u largova dhe s’kam parë më as detin e tij, as qytetin, as njerëzit. Dhe nuk kam dëshirë t’i shoh.*”²

Ashtu si në shumë romane tjera, me personazhe të veçantë, që dallohen nga rrethi në të cilin vendosen për veprim edhe në këtë prozë rrëfimtare shqipe, në të cilën autori me vetëdijen më të madhe dhe i bindur për një rrëfim të arrirë vendos që secilën ngjarje që rrjedh brenda katër vjetëve (aq sa zgjat edhe rrëfimi) ta vë si rrëfim në gojën e një personazhi femër, e cila e ndikuar edhe nga vetë ajo që ia falnin të tjerët në vazhdimësi të ditëve tipike të mentalitetit modern frymon duke mos qenë vetvetja. Këtë të fundit nuk e jep vetëm në raport me kohën e tashme, kohë të cilën e jetojnë edhe lexuesit me ç’rast edhe për to janë të njohura veprimet, frikët, dëshirat ose urrejtjet e kësaj protagonisteje, por edhe në raport me kohën e kaluar, nga e cila ajo i bart kujtimet e hidhura dhe dhimbjet më të mëdha të vetë qenies njerëzore.

E ndodhur në një mjedis njerëzish që vazhdimisht i japin urdhra për përmbushjen e nevojave të tyre, ose e trajtojnë sikur të mos jetë e nevojshme dhe e dobishme për vetë veten e saj edhe përkundër asaj që ecë në dy kohë të ndryshme (në të sotmen me këmbë, ndërsa në të djeshmen me mendje), duhet theksuar edhe ajo që ka thënë studiuesi, se: “*Ecja përpara dhe kthimi pas në kohë, me këtë rast nuk është në funksion të digresioneve, të intermexove sa për të marrë frymë apo për ta thyer monotoninë, por është natyrë bazë e rrëfimit romanesk. Gërshetimi, pleksja dhe shpleksja e etapave të ndryshme të kohës e cila shtrihet gati në pjesë më të madhe të gjysmës së dytë të shekullit aktual, dëshmon zotërimin e kategorisë më të vështirë të format e narracionit epik. E bën këtë, pa dremitur për asnjë çast, që nganjëherë u qëllon edhe më të mëdhenjve...*”³

E detyruar që krahasimin ta paraqesë vetëm në raport me veten dhe jo me dikë tjetër, ajo sillet mjaft ndryshe në raport me të tjerët, të cilët kanë patologji të shumta të bartura nga rrethi i shoqërisë së kohës. Këtë krahasim, në pjesën dërmuese të rasteve ajo e paraqet vetë, pa mos e pritur që t’ia bëjnë të tjerët, të pranishëm qoftë edhe rastësisht në jetën e saj, siç e tregojnë hapur edhe rreshtat e mëposhtëm: “*Për koleget e mia, në përgjithësi për këdo që hynte e dilte në*

¹ Kongoli, F. “Bolero në vilën e pleqve”. *BOTIMET TOENA*. Tiranë. 2009. fq. 77.

² Po aty.

³ Aliu, A. “Don Kishoti te shqiptarët”. *Flaka e vëllazërimit*. Shkup. 1995. fq. 45.

pavijon, unë kam qenë gjithmonë një send i dekorit. Një qenie në nivelin zero të zhvillimit mendor. Më urdhëronin të gjithë dhe unë u bindesha të gjithëve. Merrja përsipër edhe punë që s'më takonin, të cilat i kryeja pa u mërzhitur. Ishte mënyra ime për të mbijetuar, për t'iu përshatur një bote, ku një femër si unë mbetet jashtë loje."⁴

Herë të tjera nuk mungojnë as rrëfimet e tërthorta, të ngjeshura dhe të pasosura të këtij shkrimtari, sidomos kur me vetëdije të plotë paraqet vuajtjen e vazhdueshme të personazhit, të dhënë në një shoqëri bande, (për)dhunimi, urrejtjeje, diktature, (për)ndjekjeje, izolimi, shkatërrimi dhe djegieje të vazhdueshme, të ndodhur në vitet '97 (vite, të cilat përpos asaj që paraqesin kohën e ngjarjes brenda kësaj proze, njëkohësisht paraqesin edhe kohën e jetesës së vetë Parashqevisë).

E ndodhur në mesin e një bote të shthurur djemsh, e vetme përballë botës së personazheve femra, kjo protagoniste i përjeton ngjarjet më interesante, të cilat të paraqitura nga pena krijuese e Kongolit, i vishen asaj jo vetëm në çaste të papritura, por edhe që në fillim të romanit kur e pranon se nuk ka asgjë të përbashkët me të motrën, siç e thekson hapur me fjalët e mëposhtme: *"E kam ditur gjithmonë, në këtë botë shanset e mia janë të pakta. E kam ditur qysh se kuptova dhe e futa veten në kategorinë e të shëmtuarve. Për këtë u kam mbajtur inat gjithë jetën prindërve. U mbaj inat edhe sot. Kjo më ngarkon shpirtin rëndë: ata nuk janë më. Rajmonda, - kështu quhet ime motër, - kishte bukurinë, zgjuarsinë dhe emrin tingëllues. Mua, përveçse nuk isha e bukur, nuk më mbanin as për të zgjuar. Po të mos përmend emrin tim demode, si më dukej: Parashqevi! Emri i gjyshes, më thoshin, i gjyshes nga babai. Ç'punë kisha unë me emrin e gjyshes nga babai? I vetmi ngushëllim mbetej fakti se këtë emër e mbante një këngëtare. Por Parashqevia këngëtare ishte e bukur, kishte zë edhe më të bukur, ishte, si thuhet, një star, e njihnin dhe e donin të gjithë. Ndërsa mua s'më njihje dhe s'ma varte askush.*"⁵ [sic!]

Interesante dhe e një natyre të veçantë për Parashqevinë del edhe mënyra se si ajo e vetëdijshme për diçka të tillë, paraqet ndjenjat e ftohta kundrejt çdo gjëje me frymë dhe me shenja jete. Këtë nuk e bën e detyruar vetëm nga e tanishmja, por edhe nga vetë e djeshmja e ftohtë, si dhe nga dëshira gri e së ardhmes. Por pavarësisht kësaj, nuk duhet hedhur poshtë vetë sprovimi që ia bën autori e për këtë është përmendur edhe më herët se: *"Ruajtja e dinjitetit dhe individualitetit krijues e njerëzor është gjakimi kryesor i personazhit-narrator në këtë roman. Brenda këtij boshti qendror ndërlidhen linja të reja kuptimore si ajo e vetëflijimit dhe e sakrificës, ajo e nënshtrimit dhe e manipulimit, e frikës dhe e lirisë etj. Bota e krijuesit është ajo që në këtë vepër vihet në sprovë, bota e atyre që të vetmen lojë të cilën e zotërojnë është ajo e shkrimit, e krijimtarisë. Në këtë kontekst, autori provon dhe arrin t'ia heqë maskën kësaj bote, ta zhveshë deri në asht dhe ta shohë qartë edhe atë që është thyerje dhe varfëri e saj shpirtërore. Ironia, satira, sarkazmi e grotesku janë format kryesore të observimit dhe të shprehjes krijuese.*"⁶

Meqë tashmë u theksua se rrëfimin e kësaj vepre lexuesi e gjen në gojën e Parashqevisë, e cila për aq vite sa përkujdeset për dy pleqtë e vilës, të identifikuar me emra e me moshë (z. Irfanin, 80 vjeçar, i cili vuante nga hipertensioni, si dhe periodikisht edhe nga kapsllëku⁷; dhe znj. Firdus, 75 vjeçare, e cila vuante nga tensioni dhe nga osteoporozja, e për të cilën nuk mungon as edhe përshkrimi i jashtëm: shtatmesatare, e mbushur, e bukur, me një fytyrë të bardhë, të pastër, sy të gjelbër, të qetë, flokë të thinjur⁸), jeton fatin që ia jep vetë qyteti i Tiranës, Shqipëria tipike e çoroditur e viteve '97, si dhe mentaliteti i kohës në fjalë.

⁴ Kongoli, F. "Bolero në vilën e pleqve". *BOTIMET TOENA*. Tiranë. 2009. fq. 14-15.

⁵ Kongoli, F. "Bolero në vilën e pleqve". *BOTIMET TOENA*. Tiranë. 2009. fq. 17-18.

⁶ Aliu, A. "Don Kishoti te shqiptarët". *Flaka e vëllazërimit*. Shkup. 1995. fq. 84.

⁷ Kongoli, F. "Bolero në vilën e pleqve". *BOTIMET TOENA*. Tiranë. 2009. fq. 32.

⁸ Po aty, fq. 35-32.

Këtë fat ajo e jep të shkrirë edhe me vetë ndjenjën e autorit, për të cilën mund të thuhet, se: “Mënyra e alternimit, e relativizmit dhe, mbase shkrirjes së plotë midis narratorit dhe personazhit, në këtë roman është një tjetër karakteristikë dhe zgjidhje e qëlluar krijuese.”⁹ Imagjinata krijuese e Kongolit në raport me përfaqësuesit tjerë të kësaj periudhe letrare, përveç faktit që na njeh me fate dhe karaktere të ndryshme personazhesh, mënyrë e veçantë shkrimi për të është edhe funksionimi i po këtyre personazheve brenda hapësirave të ngushta shqiptare, siç ndodh edhe me vetë jetën dhe frymën e Parashqevisë, që jeton bashkë me dy pleqtë (zërin e linjës së dytë rrëfimore) brenda vilës me dy kate. Kjo e fundit duke qenë se edhe për nga funksionimi dhe ndërtimi ishte e veçantë, rrëfyesja vendos që atë ta përshkruajë edhe për nga pamja e jashtme.

Andaj, jo rastësisht në roman, gjenden hapur edhe rreshtat e mëposhtëm: “Shtëpia ishte vilë dykatëshe, ndërtuar midis ca pallateve të stilit të vjetër, me çati dhe mure tullash të kuqe, të pasuvatuara, në një lagje ku s’më kishte qëlluar të kaloja ndonjëherë. Nga të gjitha anët rrethohej me oborr, oborri me kangjell të lartë hekuri, ngjyer në të zezë. Në pjesën ballore, një rrugë e asfaltuar rishtazi, e ndante nga pallati më i afërt. Në krahun e majtë, një rrugë, e më tej një lulishte, krijonin një hapësirë më të gjerë midis saj dhe vargut tjetër të pallateve. Prapa i rrinte një hotel i ri, i vogël, djathtas një pallat i vjetër dykatësh, nga i cili e ndante një rrip toke mbuluar me ferra.”¹⁰

Ndonëse vepra në fjalë fund e krye na njeh vetëm me fatin e personazhit kryesor, që në këtë rast për dallim nga çdo prozë tjetër tija, e tilla është një femër e vënë përkrah moshave të ndryshme të personazheve të tjerë, nënkuptohet që prapa saj fshihet edhe një numër i madh i vajzave të (për)dhunuara e të keqpërdorura nga djemtë e bandave shqiptare, të cilët menjëherë pas prishjes së rendit shoqëror guxuan të keqpërdornin edhe qeniet më të pafajshme. Veprimet e tilla nuk u bënë vetëm si pasojë e ndodhive të mëparshme, por edhe për kënaqjen dhe përmbushjen e dëshirave të marrosura trupore e mendore, në pamundësi për t’i realizuar më parë.

Në këtë kumtesë nuk mund të mbetet anash dhe pa u theksuar as ajo që është përmendur me kohë, se: “Romani nuk përfshin vetëm ngjarjen, por edhe përshkrime të tjera, analiza ndjenjash e disponimesh, dialogë, në të cilët shihet se çka mendojnë çka ndjejnë dhe çka parandjejnë personazhet e veçanta si dhe portretet e këtyre personazheve.”¹¹ [sic!] Ajo gjë shprehet edhe në këtë roman, në të cilin fryma e dashurive të dyfishta është me bollëk dhe jashtë çdo rregulle normale të jetës. Sepse për aq kohë sa secili personazh funksionon me një jetë të tillë që e ka të pamundur të jetojë pa një femër në krahë, ose pa një mashkull të fortë dhe për aq kohë sa për to rendet në vazhdimësi e nuk mëtohet që të ndalohen, janë pikërisht këto ato që e paraqesin çrregullimin e vetë jetës.

Por kjo e fundit merr nuanca krejtësisht të paimagjinueshme kur personazhi femër brenda një veprë të caktuar letrare përdhuhet nga meshkuj të degraduar, me ç’rast ata ndikojnë që ajo të humbë çdo lidhje me jetën, të rrënojë çdo gjë të ndërtuar, të flakë tutje çdo kujtim, ose të mos besojë se jeta në të ardhmen do të jetë ndryshe. “Ishte një natë marsi, e atij marsi njerëngrënës 1997”¹². Me këto fjalë e kujton ajo historinë e trishtuar të jetës së saj (çastin e përdhunimit), ndodhi kjo e ardhur si pasojë e një përjetimi të saj me Anën, një vajzë tetëmbëdhjetë vjeçe, për të treguar më vonë se ata të gjashtë, as nuk e kishin vuarë, as nuk e kishin mbytur, por e kishin rrethuar në heshtje.¹³

⁹ Aliu, A. “Don Kishoti te shqiptarët”. *Flaka e vëllazërimit*. Shkup. 1995. fq. 45.

¹⁰ Kongoli, F. “Bolero në vilën e pleqve”. *BOTIMET TOENA*. Tiranë. 2009. fq. 32-33.

¹¹ Hoxha, H. “Teoria e novelës dhe e tregimit”. *Flaka e vëllazërimit*. Shkup. fq. 211.

¹² Kongoli, F. “Bolero në vilën e pleqve”. *BOTIMET TOENA*. Tiranë. 2009. fq. 125.

¹³ Po aty, fq. 128.

Por edhe përkundër kësaj, duhet theksuar se Parashqevia si personazh nuk e vuan vetëm faktin që është e (për)dhunuar dhe për atë bëhet simbol i vazhdueshëm me nota të thella, por karakterizohet edhe për raportin që ka me plakun e vilës, me djalin e tij, Nardin, ose me doktorin, që femrën e shihnin si objekt shfrytëzimi edhe në kohë moderne dhe jo vetëm në kohën e shturjeve të njëpasnjëshme shoqërore. Duke pasur parasysh se në këtë rrëfim të Parashqevisë vëmendja kryesore e lexuesit mbështetet në atë se si do të jepet vazhdimësia e rrëfimit të saj dhe sa ajo do të bëjë për më të mirën e jetës së saj edhe përkundër asaj që, që në fillim pohon se është ndryshe dhe e papranuar në shoqërinë e zakonshme njerëzore, duhet thënë se edhe për të interesante ishte zhdukja e letrave, të cilat dy pleqtë e vilës, i shkëmbejnë me njëri-tjetrin.

Andaj, jo më kot pas largimit të protagonistes nga vila, dalin edhe rreshtat e mëposhtëm: *“Tundimi im më i madh, për sa kohë qëndrova në vilë, ka qenë të mësoja përmbajtjen e letërkëmbimit. Zarfet e plakut ishin gjithmonë të plota, të rënda. Kuptohej, ai shkruante gjatë. Letrat e zonjës Firdus, përkundrazi, duhej të ishin të shkurta, shumë të shkurtra. Dysvoja se zarfet e saj ktheheshin bosh, aq të lehta ishin.”*¹⁴

E ndodhur në një botë të përcudnuar shqiptare dhe në një hapësirë që ia zinte frymën aq herë sa mëtonte ta largojë tjetrin si pasojë e mbjelljes së një të keqeje, ky personazh modern i Kongolit është vetja jonë e dytë sa herë që na kujtohet veprimi i brendshëm. Sepse asgjë më larg se sa një trup i (për)dhunuar, se sa një ego që ngrihet në bazë të kënaqësisë personale, se sa një sy epshor që e ngjiz veten drejt shkallëve të një “dashurie të sëmurë”, nuk mund të na drejtojë drejt asaj që është pjesë jona e njohur, si pasojë e historisë, ose si pasojë e një dëshirë që lind brenda çastit. Andaj, duke e njohur brendinë e romanit dhe veprimin e vetë Parashqevisë, edhe në kohët e mëvonshme ajo që do të mbetet zë rrëfyes është vetë trupi i saj në një truall me erë shqiptare.

Referencat

- [1]. Ali Aliu, (1995), Don Kishoti te shqiptarët, *Flaka e vëllazërimit*, Shkup;
- [2]. Fatos Kongoli, (2009), Bolero në vilën e pleqve, *BOTIMET TOENA*, Tiranë;
- [3]. Hysni Hoxha, Teoria e novelës dhe e tregimit, *Flaka e vëllazërimit*, Shkup.

¹⁴ Po aty, fq. 48-49.